



**Komuna e Pejes, Municipality of Peja, Opsina Pec  
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport  
Direktorat za Umetnost, Omladinu i Sport**

**AKTIVITETET  
të realizuara gjatë vitit  
2014**



# Raporti ka për qëllim të jep llogari dhe transparencë para qytetarëve.

## DREJTORATI PËR KULTURË RINI DHE SPORT

**D**rejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport zbaton strategjinë e gjithmbarshme dhe planin gjithëpërfshirës të punës për ruajtjen, zhvillimin dhe përparimin e segmentit të kulturës, rinisë dhe sportit në nivel komunal. Ushtron aktivitete të planifikuara duke udhëhequr me resurset (burimet) lokale, kulturore të rinisë dhe të sporteve. Organizon, debate, tryeza me shtresat e shoqërisë civile dhe organet shtetërore me qëllim të avancimit, zhvillimit dhe promovimit të fushës së kulturës, preokupimet, problematikën dhe aktivitetet e rinisë dhe të sporteve në të gjitha degët dhe disiplinat e tij. Udhëheqë me shtëpinë e kulturës, Teatrin e qytetit, Kinoteatrin, Bibliotekën Komunale, Muzeun e Pejës dhe Palestrat sportive si dhe Kompleksin Rinorë Pejë ku titullar pronësie është Komuna e Pejës. Përpjekjet e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport do të jenë në vazhdimësi të krijojë politika adekuate përmes të cilave tentohet të formohet llojlojshmëri e kulturës, rinisë dhe sportit, duke pasur kujdes në bashkërenditjen e interesave të ndryshme zhvillimore dhe do të orientohet në këto prioritetet:

- Vazhdimësi, konsolidimi i institucioneve ekzistuese dhe themelimi i institucioneve të reja (që është bazë permanente për zhvillimin afatgjatë të veprimtarive kulturore rinore e sportive),
- Krijimi i kushteve teknike e profesionale në Institucione sipas standardeve evropiane,
- Profesionalizimi i kadrove në Institucione ekzistuese,
- Organizimi i aktiviteteve dhe shënimi i datave me rëndësi të veçantë historike,
- Përkrahja dhe subvencionimi material për krijimtarinë individuale dhe kolektive, duke krijuar mekanizma të nevojshëm për ofrimin e ndihmesës,
- Ndihmesa e iniciativave kulturore, rinore e sportive me interes të gjithmbarshëm,
- Shkëmbimi i përvojave me vende të rajonit dhe më gjerë.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport përbëhet prej tre sektorëve të veçanta: Sektorin e Kulturës, Sektorin e Rinisë dhe Sektorin e Sportit.

## SEKTORI I SPORTIT

**S**ektori i Sportit i cili vepron në kuadër të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sporti konsiston në përgatitjen, vlerësimin dhe aprovimin e politikave programore të sportit, të cilat kanë të bëjnë me masivizimin e sportit dhe zhvillimin kualitativ të tij.

Sektori i Sportit mirëet me organizmin e ngjarjeve të rëndësishme me karakter ndërkombëtar dhe mundësisë për të prezantuar kualitetet sportive jashtë vendit, me çka do të ndikohet pozitivisht edhe në avancimin e përgjithshëm të sportit vendor.

Sektori i Sportit është të ndihmojë organizimin e garave të ndryshme në Komunën e Pejës të cilat do të ndikojnë në: Ngritjen e nivelit të sportit në Komunën e Pejës, afirmimin e kulturës sportive në vend dhe jashtë, stimulimin e sportistëve që të jenë aktiv në sport dhe të punojnë në avancimin e mëtejshëm, përgatitjen e sportistëve për pjesëmarrje në garat zyrtare si dhe përkrahja e federatave për organizimin e ngjarjeve me karakter ndërkombëtar.





## SEKTORI I KULTURËS

**S**ektori i Kulturës si pjesë e rëndësishme e Drejtoratit për Kulturë Rini dhe Sport, merret me organizimin institucional të institucioneve të kulturës, përpilon plane zhvillimore dhe planin vjetor të punës për institucionet dhe asociacionet e kulturës.

Sektori i Kulturës harton dhe zbaton politika zhvillimore në fushën e arteve skenike-muzikor, arteve vizuale-pamore, botimeve dhe bibliotekarin sipas standardeve evropiane, duke konsideruar kulturën si një mekanizëm me ndikim të fuqishëm për zhvillimin në Komunën e Pejës, si dhe përafrimin e vlerave kulturore si identitetet përmes aktiviteteve ndërkombëtare.

Sektori i Kulturës nxitë dhe motivon krijimtarinë artistike të brezit të ri për përfshirjen e tyre në jetën artistike si dhe ngjallja e kujtesës së të rinjve për bartësit e programeve dhe kulturës ndër vite në përgjithësi si bazë historike kulturore të komunës së Pejës dhe Republikës së Kosovës dhe më gjerë.

Sektori i Kulturës kultivon shumëllojshmërinë e kulturës pejane, e cila do të jap një garanci e përhapjes së vlerave kulturore të të gjithëve në komune si dhe angazhohet për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në Pejë dhe rrethin.

## SEKTORI I RINISË

**S**ektori i Rinisë, i cili vepron në kuadër të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sporti ka si mision, fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e mjedisit përkrahës për zhvillimin shoqëror dhe personal të tyre, krijimin e mundësive për promovim, zhvillim dhe pjesëmarrje të të rinjve në jetën aktive shoqërore si dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta për të rinjtë, që mundësojnë zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe vlerave shoqërore, duke respektuar veçoritë individuale tek të rinjtë.

Sektori i Rinisë bashkëpunon me Drejtorinë e Arsimit në lidhje me reformat dhe kushtet që mundë ti kenë të rinjtë (duke organizuar, gara, kuize dhe forma të tjera të aktiviteteve kulturore shkencore dhe sportive). Organizon, anketa, seminare dhe trajnime të ndryshme, me qëllim të njoftimit, promovimit dhe inkuadrimin të të rinjve kosovar në aktivitetet rinore evropiane e botërore. Gjithashtu bashkëpunon me departamentet e tjera administrative, me komunën, me agjencitë e tjera ndërkombëtare dhe qeveritare si dhe me organizatat joqeveritare joqeveritare për të përparuar zhvillimin dhe zbatimin koherent dhe efikas të politikave dhe resurseve të rinisë.

Sektori i Rinisë organizon fushata me rininë dhe me shoqërinë në përgjithësi për luftën kundër substancave psikotrope (drogës, duhanit, alkoolit, etj) dhe fushata tjera nga preventiva shëndetësore në luftën kundër HIV – AIDS, prostitucionit dhe dukurive tjera negative në shoqëri.

Sektori i Rinisë identifikon grupe të caktuara të rinisë si dhe zhvillon programe për t'u marrë me nevojat e tyre. Grupet e tilla mund të përfshijnë rininë jashtëshkollore, rininë analfabete, rininë e papunësuar, rininë refugjate të kthyer, rininë e droguar, rininë e familjeve me një prind, rininë prindër të vetëm, rininë me qasje të pakët ndaj objekteve sanitare dhe shëndetësore ose në rrezik nga marrja e ndonjë sëmundjeje dhe rininë e pakicave.

## "Bëjë diçka ndryshe, bëhu kreativ"



me datë 29 Janar 2014 "Bëj diçka ndryshe, bëhu kreativ" ishte aktivitet i organizuar nga DKRS/Spektori i Rinisë në bashkëpunim me Qendrën Rinore Peja. Gjatë këtij aktiviteti u zhvillua një tryezë e rrumbullakët, një ekspozitë e punimeve rekreative dhe aheng i vogël i përcjellur me muzikë të lehtë. Aktiviteti filloi në ora 18:00 në Qendrën Rinore Peja ku morën pjesë rreth 50 të rinj të Qendrave dhe OJQ –ve rinore. Në këtë pjesë u diskutua për situatën aktuale të të rinjve të Pejës, pastaj mundësinë e përkrahjes së të rinjve kreativ si dhe u zhvilluan biseda interaktive në mes të rinjve pjesëmarrës. Pjesa e dytë e aktivitetit u zhvillua në Galerinë e Arteve në Shtëpinë e Kulturës ku morën pjesë artistët të rinj, profesionist të tjerë të Komunes së Pejës. Në përfundim të këtij aktiviteti "Bëjë diçka ndryshe, bëhu kreativ", u ndan mirënjohje për artistët e rinj pjesëmarrës në shenjë falënderimi ndaj kontributit të dhënë për këtë aktivitet rinor kreativ të realizuar.



# SHKURT



Me datë 16 shkurt 2014 për nder të gjashtë vjetorit të pavarësisë së Kosovës u organizua aktiviteti rinor Public Dance, Grafit, Parkour & Break Dance i mbajtur në qendër të qytetit të organizuar nga Sektori i Rinisë në bashkëpunim me Qendrën Rinore Peja.

Aktiviteti filloi nga ora 12:00 me vizatime grafiti ku disa nxënës të shkollës së Artit në Pejë vizatuan nëpër hamera figura të ndryshme grafiti, pastaj në ora 13:00 u realizua një demonstrim i sportit parkour i cili është një sport shumë i rrallë ku talentet e rinjë të Pejës realizuan enkas për qytetarët në qendër të qytetit. Pas kësaj ata përformuan edhe break dance gjithashtu duke demonstruar forma të ndryshme gjimnastikore.



# SHKURT



Me Datë 17 shkurtit 2014 në kuadër të shënimit të gjashtë vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, u mbajt Akademi Solemne në teatrin "Istref Begolli" në Pejë. Numri i pjesëmarrësve ishte rreth 250 mysafir. Me nga një fjalë rasti në këtë Akademi solemne para të pranishmëve u prezantuan Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Islam Husaj kryesues i Kuvendit Komunal. Ndërkaq Akademia u përcoll edhe me pika artistike të realizuara nga kori i shkollës së muzikës "Halit Kasapolli".



# SHKURT



Me datë 16 shkurt 2014 Në kuadër te aktiviteteve artistike për shënimin e ditës se Pavarësisë së Kosovës, në Pejë u organizua edhe ekspozita e artistëve të artit pamor e cila u realizua në bashkëpunim më Shoqatën Rajonale dhe artistëve të qytetit të Pejës, si dhe Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Hapjen e ekspozitës e bëri Drejtori i DKRS-ës z. Engelbert Zefaj. Ndërsa, juria për punimet më të mira shpërbleu piktoret Isa Alimusaj – pikturë, Fatmir Gjevukaj – pikturë, Skender Boshtrakaj – skulpturë.



# SHKURT



## Ekspozitë personale e piktorit Ethem Baymak

Me datë 26 shkurt 2014, në Galerinë e Arteve – Pejë u mbajt ekspozita personale e piktorit Ethem Baymak “Flladet e Ballkanit”. Fjalën përshëndetëse e prezantoi drejtori i Qendrës Kulturore Turke “Yunus Emre” z. Mustafa Altug, pastaj foli edhe Kryetari i Komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxheri.

Në këtë ekspozitë mori pjesë edhe ambasadorja e Turqisë për Kosovë znj. Songül Ozan e cila gjithashtu foli disa fjalë rasti dhe në fund mori fjalën edhe piktori i kësaj ekspozite z. Ethem Baymak.

Prizreni shquhet me lashtësinë e vet me realitetet e veta arkitektonike dhe urbane me bukurinë e peizazhit ndaj është e arsyeshme që këtë qytet muze ta trajtoi edhe piktori e poeti Ethem Baymak, u tha nder të tjera në këtë ekspozitë.



# SHKURT



Me datë 14 shkurt 2014 në kuadër të gjashtë vjetorit të pavarësisë të rinjtë pejanë organizuan Festivalin Rinor ku shfaqën drama, dokumentare, xhirime për nder të pavarësisë së Kosovës e ku ishin të përmbledhura mesazhet nga të rinjtë si dhe xhirimet nga viti i shpalljes së pavarësisë e deri më sot, ky dokumentar u përgatit nga të rinjtë e Qendrës Rinore Atë Lorenc Mazrreku. Në vazhdim të aktivitetit u shfaq një video komedi ku ishin të përmbledhura xhirime të ndryshme komedi më të shikuara në botë e përgatitur nga Qendra Rinore Peja. Pas kësaj u shfaqen edhe dy drama njëra me tematikë për pavarësinë e Kosovës të përgatitura nga nxënësit e shkollës "Xhemajl Kada" me titull "Mëmëdhe më quhet toka aty ku më ka rënë koka" si dhe drama e dytë në zhanrin e komedisë e përgatitur nga nxënësit e shkollës së mesme të artit "Odhise Paskali" dhe OJQ "Nisma për paqe dhe unitet" e titulluar "N'sho lerë". Dhe e gjithë programi u përfundua me një performim nga mjeshtri i magjisë iluzioniste Ilir Ferizi i cili mahniti afro 300 shikues me magjinë e tij.

# SHKURT



Me datë 17 shkurt 2014 u organizua Koncert i muzikës klasike nën organizimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Shkollën e Muzikës “Halit Kasapolli”. Në teatrin “Istref Begolli” në Pejë, shkolla e muzikës “Halit Kasapolli” nën përkujdesjen e dirigjent, prof. Memli Kelmendi mbajti koncertin e muzikës klasike, për nder të 17 shkurtit, gjashtë vjetorit të Pavarësisë. Pjesëmarrës në këtë koncert ishin rreth 250 persona.



# SHKURT



Me datë 16 shkurt 2014 u organizua Koncerti i muzikës popullore për nder të gjashtë vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Në Teatrin "Istref Begolli" në Pejë , u mbajt koncerti i muzikës popullore përcjellur nga orkestra e qytetit, për nder të 17 shkurtit, gjashtë vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Koncerti është organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Në koncert morën pjesë shumë këngëtar të rinjë të cilët i sollën në skenë në mënyrën më origjinale këngët e mirëfillta popullore. Pjesëmarrës në këtë koncert ishin rreth 250.

# SHKURT

## Koncerti Rinor për ditën e pavarësisë



Me datë 17 shkurt për ditën e pavarësisë së Kosovës në qendër të qytetit u mbajt koncerti rinor. Është organizuar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport – Sektori i Rinisë. Në koncert morën pjesë të rinjtë këngëtar dhe grupe rinore të komunës së Pejës. Koncerti përmbante zhanre të ndryshme të muzikës si muzikë popullore, rep, pop si dhe rok. Pjesëmarrës në këtë koncert ishin mbi 2000 persona.



# SHKURT



Me datë 15 shkurt 2014 në Teatrin “Istref Begolli” u dha shfaqja “Miu” me regji të Arbresha Grabovci Nixha, tekstin e shkruajti Shaip Grabovci. Ndërsa në role lutjen Fitore Broqi, Fidan Mamusha dhe Flormend Shabaj. Në këtë shfaqje morën pjesë rreth 150 shikues.

# SHKURT



## Sportistët e merituar të vitit

Me datë 02 shkurt 2014, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, Sektori i Sportit, ka organizuar ceremoninë për nderimin e sportistëve, klubeve, dashamirësve dhe punëtorëve sportiv të vitit.

Këshilli Profesional i Sportit në bashkëpunim me klubet sportive kanë bërë nominimet kurse këshilli sportiv i cili ka 21 anëtarë ka bërë përzgjedhjen e më të merituarve të cilët kanë marrë pëlqimin e plotë të Këshillit Profesional Sportiv.

Mirënjohjet dhe shpërblimet janë ndarë sipas këtyre meritave:

Punëtori sportiv, nderimi post mortum, për kontribut në zhvillimin e sportit, për vepër jetësore, gazetarin sportiv, klubi më i mirë, trajneri më i suksesshëm, 10 sportistët e dalluar, 10 sportistët me perspektiv, dy sportistët më të mirë të ri, sportistja dhe sportisti i vitit,

Mirënjohjet janë ndarë nga Kryetari i Komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxheri dhe bashkëpunëtorët e tij si dhe nga personalitete të artit dhe të sportit të qytetit të Pejës.

Të përzgjedhurit kulmor të Komunës së Pejës për vitin 2013 janë: Supersportistja e vitit – Majlinda Kelmendi, Sportistja e vitit – Nora Gjakova dhe Sportisti i vitit – Samir Shaptahoviç, Trajneri Driton Kuka dhe Klubi i Xhudos Ippon.

Këtë vit, Komuna e Pejës ka ndryshuar formatin e ceremonisë. Për dallim nga vitet e kaluara sivjet janë nderuar dhe shpërblyer sportisti dhe sportistja e vitit dhe supersportisti i vitit.



# SHKURT




Me datë 11 shkurt 2014 në Palestrën e Sporteve "Karagaç", u realizua gjiroja e parë e turnirit në Futsall për shkollat e mesme të ulëta e organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport- Sektori i Sportit. Në Turnir garuan 21 ekipe nga SH.M.U të të Komunës së Pejës. Me vendin e parë u shpërblye shkolla "Vaso Pashë Shkodrani" – Pejë.



# MARS

## DITA BOTËRORE E TENISIT



Me datë 4 mars 2014, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport së bashku me klubin e Tenisit Peja ka organizuar Ditën Botërore të Tenisit. Qëllimi kryesor i organizimit të kësaj ngjarje të rëndësishme është sensibilizimi i qytetarëve në edukimin e fëmijëve në frymën rekreativo-sportive dhe për lojën e Tenisit. Ky manifestim është vlerësuar nga Federata Ndërkombëtare e Tenisit (ITF) si një ndër pesë organizimet më të mira në Botë!



# MARS



## Debat publik me të rinjët “Siguria nëpër shkolla”

Me datë 19 mars 2014 në Sallën e Kuvendit Komunal Pejë, u organizua debat publik me të rinjë me temë “Siguria në shkolla”. Debatu është organizuar nga sektori i rinisë, në bashkëpunim me Qendrën Rinore Peja dhe me Qendrën At Lorenc Mazreku. Debatin e përshëndeti me një fjalë rasti drejtori i DKRS-ës z. Engelbert Zefaj si dhe Jeta Nushi shefja e sektorit të rinisë e cila dhe bëri prezantimin e qëllimit të këtij debati. Në këtë debat morën pjesë zyrtari për Arsim - z. Mon Berisha, nga Drejtoria Rajonale e Policisë - kapiten Nue Nikolla, profesor i mendimit pozitiv - z. Daut Demaku, nga Forumi për Iniciativ Qytetare – Nazim Haliti, nga Qendra për Punë Sociale - Vera Kolgjeraj, nga Shërbimet Sprovuese – Shaban Nikçi, psikologe Ergita Zajmi. Debatu u përcoll me interesim nga afro 200 pjesëmarrës.

# MARS



## Ekspozitë personale e Liridona Gjukës

Në Galerinë e Arteve në Pejë me datë 07 mars 2014 u mbajt ekspozitë personale e prof. Liridona Gjukës. Në këtë Ekspozitë folësit e çmuan lartë angazhimin dhe veprën artistike të piktores, e cila premtan se do të arrijë majat e artit pamor në Pejë dhe më gjerë. Në këtë ekspozitë morën pjesë piktorë nga Shoqata e Artistëve Figurativë e Aplikativë të Pejës, profesor të shkollës së Arteve "Odhise Paskali" dhe Akademisë së Arteve nga Prishtina, si dhe dashamirës të arteve pamore dhe familjarë të Liridona Gjukës.



# MARS



Me datë 29 mars 2014 në Komunën e Pejës është realizuar aktivitet sportiv multietnik. Është organizuar nga Qendra për Tolerancë dhe Integrim, bashkë financuar nga Komuna e Pejës dhe është zhvilluar në palestrën sportive të qendrës rinore "QRALM" e cila ofroj palestrën në shërbim për këtë aktivitet. Qëllimi i këtij aktiviteti është që të forcohet bashkëjetesa etnike në Kosovë. Pjesëmarrës ishin të rinj të komunitetit Turk nga Mamusha, nga komuniteti Serb nga Gorazhdeci, nga komuniteti Boshnjak nga Vitomirica, nga komuniteti Egjiptian dhe Rome nga Peja dhe të rinj Shqiptar nga Peja.

## Drejtoria për kulturë, Rini Dhe Sport - Sektori i rinisë



Më datë 12 mars 2014 Sektori i rinisë, mbajti takim me të rinjtë e Pejës të cilët morën vendin e dytë për artikullin me të mirë të shkruar për tu publikuar në Wiki Academy.

Drejtori i DKRS i falënderoi dhe i përgëzoi për punën që e kanë bërë dhe i uroi që dhe në të ardhmen të kultivojnë këto zeje, duke shkruar dhe plasuar në media.

Të rinjtë pjesëmarrës e falënderuan drejtorin për ftesën dhe për përkrahje dhe folën për përvojën e mirë gjatë këtij aktiviteti si dhe punë pak të vështirë në mungesë të informacioneve.



# PRILL



## Turniri Ndërkombëtar “Judo for Peace”

Më datë 8 Prill 2014 në Palestren e Sporteve “Karagaqi” është mbajtur Turnir Ndërkombëtar “Judo for Peace” e organizuar nga Klubi i Xhudos Ippon në bashkëpunim me federaten e Judos dhe të mbështetur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - sektori i Sportit. Pjesëmarrës ishin shumë shtete. Si dhe garues kulminant në mesin e të cilëve edhe Kampionja e Botës Majlinda Kelmendi, si dhe Larisa Čeric nga Bosnja e Hercegovina.



# PRILL



Me datë 22 prill 2014 në qytetin e Pejës u festua Dita Ndërkombëtare e Tokës. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - Sektori i Rinisë së bashku me Qendrat Rinore, OJQ Rinore, Shkollat e Mesme dhe Fillore dhe grupet joformale rinore organizojnë Ditën Ndërkombëtare të Tokës. Aktiviteti filloi nga ora 11:00 me pastrimin e qytetit dhe pjesët rajonale të komunës së Pejës, pastaj vazhdoi me ekspozitë të punimeve recikluese të punuar nga nxënësit e shkollave fillore të komunës së Pejës, me program artistik argëtues me mesazh mbi ruajtjen e ambientit, me ngjyrosjen e rrugës së korzes nga fëmijët parashkollor, sfilat e modës me material reciklues dhe përfundoi në ora 17:00 me program për fëmijë ku shfaqen një shfaqje me tematik për mbrojtjen e mjedisit nga dukuritë negative. Kjo shfaqje u realizua në parkun e qytetit "Karagaç". Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin 700 të rinjë të komunës së Pejës. Motoja e kësaj dite ishte "Go Green or Go Home"



# PRILL

## Ekspozita me punime artistike me mjete recikluese



Me datë 30 prill 2014 në Galerinë e Arteve në Pejë u mbajt ekspozita me punime artistike dhe mjete recikluese, si dhe fotot e aksionit të pastrimit nga nxënësit e shkollave të mesme dhe fillore të Komunës së Pejës. Pjesëmarrës ishin shumë të rinjë dhe nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Pejës në këtë ngjarje. E veçanta e kësaj ngjarje ishte shpërblimi për punimet më të mira dhe për grupet e pastrimit të cilët kishin pastruar vende me më shumë mbeturina dhe kishin grumbulluar numër të madh të mbeturinave.



# PRILL



Me datë 23 prill 2014 u organiza pritja solemne për Xhudistën pejane Majlinda Kelmendi Xhudistja kampione Majlinda Kelmendi ka zënë vendin e parë në Kampionatin Evropian, i cili u zhvillua në Francë duke fituar medaljen e artë. Për të nderuar këtë ambasadore të sportit Kosovar ,Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoj një pritje solemne.

Nën patronatin e Kryetarit te Komunës së bashku me këshillin profesional është organizuar një darkë solemne për ta nderuar kampionen e Evropës.

Pjesëmarrës ishin persona të shquar të qytetit të Pejës mes tjerash dhe Kryetari i Komunës së Pejës z.Gazmend Muhaxheri dhe drejtori i DKRS-ës z. Engelbert Zefaj.



# PRILL

TRUPA TEATRALE PROFESIONISTE TTP

**KOMEDI**  
**"AKRABALLËKU"**

Autor: **Kristo Floqi**  
Regjia: **Rudina Zhara Gruda**  
Luajnë: **Blerim Kelmedi**  
**Shpresa Salihaj**  
**Luan Daci**  
**Liridon Nikqi**  
**Rudina Zhara Gruda**

Shkruar: *Abza Gashi, Ari Pasha, Ari Leka, Qilim Sadriqi, Dier Vuçetaj, Djin Mulliqi, Euran Shola, Janina Buçi, Imelda Music, Rilind Vuçetaj*

Skenografia & Kostumet: **Gresa Zajmi**  
Teknika & Muzika: **Ismet Nikqi**  
Ndriqimi: **Ali Thaqi**  
Gëtimi: **Liriana Nimanj**  
Organizator: **Ilirdon Rexhepi**

Me: 12.04.2014  
Ora: 20:00  
Vendi: Teatri "Istref Begolli"  
Pejë



Me datë 12 prill 2014 në teatrin "Istref Begolli" u mbajt shfaqje e zhanrit komedi "Akraballëku". Autor i kësaj shfaqje ishte Kristo Flori, regjia Rudina Zhara Gruda dhe luajtën Blerim Kelmendi, Shpresa Salihaj, Luan Daci, Liridon Nikqi si dhe Rudina Zhara Gruda. Pjesëmarrës në këtë shfaqje ishin rreth 200 persona.

# MAJ



Me datë 03 maj 2014, në Galerinë e Arteve në Pejë u mbajt ekspozitë personale e piktorit Fatmir Gjevukaj. Fjalën përshëndetëse e mori Shefi për Kulturë z. Aver Husaj, menaxheri i Galerisë së Arteve, Zymer Mulliqi, si dhe piktori Skender Boshtrakaj dhe në fund dhe autori i ekspozitës përshëndeti dhe falënderoi të gjithë të pranishmit. Në këtë ekspozitë ishin të paraqitura rreth 18 piktura të këtij piktori. Ndërsa pjesëmarrës ishin një numër i konsiderueshëm dashamirës të artit.




# MAJ



Me datë 25 maj 2014 Motocross Team Peja organizoi garën ndërkombëtare në motokros, nën mbështetje të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Pjesëmarrës ishin motoristët nga Kosova, Shqipëria dhe Mali zi. Pjesëmarrës ishin rreth 100 persona dashamirës të sportit motokros.





Me datë 22 maj 2014 në teatrin "Istref Begolli" në Pejë, u mbajt Manifestimi qendror i "Takimeve letrare Azem Shkrelli". Hapjen e këtij manifestimi e bëri i pari i Komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxheri. Programi vazhdoi me deklamime poezish nga shkrimtarë vendas dhe ndërkombëtarë si: Safet Hadroviç, Belfjore Qose, Omer Edrem, Lulezim Haziri, Paulo Grigoli, Vehbi Miftari, Lulzim Tafa, Vilson Culaj, Muhamet Kerveshi, Marigone Kelmendi.

Programi u shoqërua edhe me pika artistike interpretuar nga: aktorët e teatrit dhe kori i shkollës së muzikës "Halit Kasapolli" me dirigjent maestro Memli Kelmendi.

Manifestimi vazhdoi me ndarjen e çmimit Laureat "Takimet letrare Azem Shkrelli", të cilin për këtë vit e mori Dr. Anton Nik Berisha



# MAJ



Me 31 maj 2014 në Qendrën Multi-profesionale në Fierze u mbajt aktiviteti për nder të 1 qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.

Qendra Multi-profesionale në Fierzë organizoj aktivitet ku u shënuar me sukses dhe morën pjesë një numër i madh i fëmijëve, të cilët shfaqën më anë të punimeve ide të tyre shumë interesante dhe dëshirat e tyre për të ardhmen.



# MAJ



Me datë 31 maj 2014 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me klubin "Oldtimer Club" nga Peja kanë organizuar në qendër të qytetit revijalin e veturave të vjetra. Veturat ndaluan në qendër të qytetit ku zgjoi interesim nga ana e qytetarëve të Pejës. Kishte mysafir edhe nga Evropa ku ishin mbi njëzet vetura. Mysafirëve ju shtrua një drek solemne, ku pjesëmarrës ishte edhe drejtori i DKRS-ës z. Engelber Zefaj me ç'rast i përshëndeti mysafiret me një fjalë rasti.



# MAJ



Me datë 11 maj 2014 në Palestrën e sporteve "Karagaçi" në Pejë, klubi i Karatesë Ippon në mbështetje nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe FKK organizuan Turneu "HAKI IBËRDEMAJ". Nxënësit e klubit Ippon fituan gjithsej shtatë medalje, prej te cilave 2 të arta, 2 të argjendta dhe 3 të bronzta. Pjesëmarrës ishin 27 klube.



## U bë hapja e “Takimeve letrare - Azem Shkreli”

Me 22 maj 2014 u bë hapja e Manifestimit të edicionit të dymbëdhjetë “Takimet letrare – Azem Shkreli” në hapësirat e Universitetit Publik “Haxhi Zeka”. Fjalën përshëndetëse e mori prorektorja e Universitetit znj. Drita Begolli, pastaj Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Islam Husaj, i cili në emër të Kryetarit të Komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxheri përshëndeti të pranishmit.

Manifestimi vazhdoi me orën e madhe letrare e cila u mbajt në Bibliotekën e qytetit “Azem Shkreli” Në këtë orë letrare u bë ndarje e çmimit” Bulëzat “ për krijuesin e ri të suksesshëm, çmimin e fitoi poetja Marigona Kelmendi nga Peja me librin “Ecje drite”. Programi u shoqërua me pika artistike dhe me deklamime poezish nga krijuesit pejan.



# MAJ



Me datë 08 maj 2014 u bë vizita e ambasadorit italian në Kosovë dhe e Drejtoreshës për hulumtime në politika rinore, barazi gjinore, zhvillim dhe bashkëpunim Sara Ferrari dhe Trentino Kosova. Koordinatorja e Qendrës Rinore Peja e informoj Ambasadorin për aktivitetet që zhvillohen në kuadër të qendrës dhe për arritshmëritë e saj ndër vite. Në këtë takim morën pjesë edhe vullnetar që e gravitojnë qendrën.

# QERSHOR



Me datë 26 qershor 2014 Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport- Sektori i Rinisë në bashkëpunim me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF në Pejë organizuan një ligjëratë me të rinj e qytetit kundër përdorimit të drogës.

Qëllimi i kësaj ligjërate ishte që të rinjtë të informohen për llojet e drogave, formave, efektet negative të tyre, simptomat si dhe mënyrat e shërimit nga vartësia e drogës. Në këtë ligjëratë morën pjesë të rinjtë vullnetar të OJQ-ve Rinore.



# QERSHOR



Me datë 16 qershor 2014 në Qendrën Rinore në Vitomericë dhe stadiumin e KF "Behari" Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport-Sektori i Sportit organizoi aktivitete te shumta sportive në futboll , atletikë, por nuk u la anash as shahu. Interesimi i të rinjëve ishte shumë i madh ku morën pjesë të rinj të moshave të ndryshme në këto aktivitete.



# QERSHOR



Me 16 qershor 2014 nën patronatin e Kryetarit të komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxheri dhe në organizim të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport, janë zhvilluar shumë aktivitete kulturore e sportive për të shënuar 15 vjetorin e Ditës së çlirimit të Pejës.

Në ditën festive të 16 qershorit aktivitetet filluan duke bërë homazhe për Dëshmorët e Kombit, me ngritjen e flamurit nën intonimin e hymnit shtetëror, për të vazhduar me ceremoninë qendrore në parkun e paqes "Ibrahim Rugova", ku fjalën e hapjes së këtij manifestimi e pati Kryetari i Komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxheri.

Aktivitetet kanë vazhduar me koncert për fëmijë në qendër të qytetit ndërsa në mbrëmje është mbajtur një koncert me muzikë popullore dhe krejt në fund aktivitetet janë përmbyllur me një koncert rinor, ku përformuan grupi "Nebulla" dhe kënetarë të rinjë të Pejës.



# QERSHOR

## Organizimet për ditën Ndërkombetare të Fëmijëve



Me datë 01 qershor 2014 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport – Sektori i Rinisë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve – 1 qershorit organizojë aktivitete për fëmijë. Sektori i Rinisë në bashkëpunim me Qendrën Rinore Peja, OJQ Nisma për Paqe dhe Unitet dhe OJQ Sport Sans Frontiers organizuan aktivitete rekreative ku morën pjesë rreth 80 fëmijë. Ky aktivitetet u organizua në parkun e madh të qytetit "Karagaq". Gjithashtu u organizua edhe një ekspozitë me piktura nga Lorik Berisha i cili i ekspozoi punimet e tij personale.

# QERSHOR



Me datë 16 qershor 2014 Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport sektori i Kulturës mbështeti shfaqjen e dhënë para publikut të Pejës për nder të 15 vjetorit të Çlirimit të Pejës.

Për nder të 15 vjetorit Ditës së Çlirimit të Pejës është dhënë shfaqja e zhanrit komedi "Dy dyzina me trëndafila të kuqërremtë", nga trupa e teatrit të Shkodrës, në Teatrin "Istref Begolli" në Pejë. Publiku është ndarë i kënaqur nga performanca e artisteve në skenë.



# QERSHOR



Photo: Shkëlzen Rexha / © Valed Promotion

Me datë 07 qershor 2014 në Teatrin "Istref Begolli" është mbajtur shfaqja komedi "Njeriu që pa vdekjen me sy" në regji të Ahmet Jakupit. Ndërsa me 08 shtator 2014 kjo shfaqje mori pjesë në Festivalin "Komedia Fest" në Gjakovë.

# QERSHOR



Me datë 04 qershor 2014 u dhuruan më shumë se 900 topa për te rinjtë e Pejës, Drejtoria për Kuliturë, Rini dhe Sport-Sektori i sportit në bashkëpunim me SSF ka organizuar shpërndarjen e topave për shkollat dhe qendrat rinore të Pejës, me ndihmën e partnerëve të saj: M.K.R.S ,BpB Bank dhe IRD.

Prezent ishin drejtorët e shkollave si dhe Drejtori i Arsimit.

Po ashtu në stadiumin e qytetit është mbajtur Turniri në futboll.

Pjesëmarrës ishin 100 fëmijë.



# QERSHOR



Me datë 25 qershor 2014, Sektori i Rinisë, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal të Pejës në bashkëpunim me OSBE-në, mbajtën një takim me të rinjtë për ta promovuar KVRL-në, dhe për t'i informuar më shumë për aktivitetet dhe trajnimet që i organizon KVRL-ja bashkë me Sektorin e Rinisë pranë DKRS-ës.

Temat që u diskutuan ishin , misioni i KVRL-së, aktivitetet që janë mbajtur deri më tani dhe ato që do të zhvillohen, mënyra e regjistrimit në KVRL. Gjithashtu edhe nga Shefja e Rinisë i informoi lidhur me aktivitetet dhe projektet që janë zhvilluar si dhe për ato që do të zbatohen gjatë 2014-ës.

Pjesëmarrës ishin përfaqësues të OSBE-së , Shefja e rinisë , Kryesia e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal të Pejës, përfaqësuesi i Shtëpisë së Kulturës të Vitomericës dhe të rinj vendas.

# KORRIK



## Përcjellja e finales së kampionatit Botëror "Brazili 2014"

Me datë 13 korrik 2014 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - Sektori i Rinisë organizoj përcjelljen e finales së kampionatit botëror "Brazili 2014" në qendër të qytetit. Aktiviteti filloi dhe u përmbyll me Dj muzik nga Dj Versus. Pjesëmarrës në përcjelljen e lojës ishin KF Besa dhe KF Besa Junior si dhe qytetarët e Komunës së Pejës dhe diaspora. Numri i pjesëmarrësve ishte i kënaqshëm.



# GUSHT



Me datë 24 gusht 2014 u organizuan aktivitetet rinore të dala nga bashkëpunimet e Komunës së Pejës dhe Organizatës Italiane Trentino me Ballkanin.

Kampi Veror 2014 është organizuar nga Qendra Rinore Peja në bashkëpunim më OJQ Nisma për Paqe dhe Unitet mbështetur nga organizata Italiane ATB, Kooperativa Ariana dhe bashkëpunëtorët e tjerë.

Qëllimi kryesor i këtij organizimit ishte protagonizmi rinor dhe mbështetja e fëmijëve që braktisin shkollën.



# GUSHT



Me datë 12 gusht 2014 për nder të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë është organizuar debat publik. Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport-Sektori i Rinisë në bashkëpunim me Këshillin e Veprimit Rinor Lokal në Pejë organizuan debat publik me të rinjtë me temë "Informimi dhe regjistrimi i të rinjëve në Entin e Punësimit". Qëllimi i këtij organizimi ishte vetëdijesimi i të rinjëve për rolin që e ka Enti i Punësimit. Pjesëmarrës ishin rreth 200 të rinj.



# GUSHT



Me datë 15 - 16 Gusht është organizuar ekspozitë për nder të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë  
Në qendër të qytetit është mbajtur ekspozitë nga Armend Nikqi dhe Genti Mulaj me titullin "Qyteti im".  
Punimet e ekspozuara nga dy talentet e rinj kishin në theks arkitekturën tradicionale të ndërtimitarisë në qytetin e Pejës.  
Punimet u shikuan nga një numër i madh vizitorësh.



# GUSHT



KOMUNA E PEJËS  
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

LOJËRAT TRADICIONALE  
**RUGOVA**  
2014

KUQISHTË, 03/08/2014

Programi:

- Hapja Solemne në orën 12:00
- Ngritja e Flamurit - Hymni
- Programi Artistik (rapsodë dhe solistë)
- Hudhja e Ilstarit
- Ngjitja në shilor
- Hudhja e gurapeshit
- Tërheqja e litarit
- Paraqitja e Ansambleve nga të gjitha trojet etnike me programet e tyre autoktone
- Garë në sharrën e vokat
- Prëzimi i duarve
- Mundje

**7 DISCIPLINA  
SPORTIVE  
ANSAMBLE  
SHKA  
DHE  
RAPSDË  
NGA TREVAT  
SHQIPTARE**

MINISTRI E KULTURËS  
MINISTRI E RINI DHE SPORTIT  
KEP




Me datë 03 gusht u zhvilluan Lojërat Tradicionale të Rugovës, shprehje e trashëgimisë sonë kulturore në Rugovë, Lojërat Tradicionale të Rugovës te organizuara nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të mbështetura nga Kryetari i Komunës, z.Gazmend Muhaxheri. Lojërat u zhvilluan në 7 disiplina sportive, ansamble dhe shoqëri kulturore artistike, rapsodi etj. Bukurinë e këtyre Lojërave ia shtuan të pranishmit qytetar nga vendi dhe diaspora. Fituesit u shpërblyen me mirënjohje dhe ngjarja u përcjell dhe nga mediat.



# GUSHT

## Ngjyrosja e Urës së Gurit në Pejë nga të Rinjtë.



Me datë 12 gusht për nder të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë ,Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport sektori i Rinisë së bashku më disa vullnetar të rinj që si qëllim kanë kontributin në dobi të pastërtisë së qytetit të Pejës, në mënyrë vullnetare bënë ngjyrosjen e urës së Gurit si shenjë sensibilizimi dhe përqimi të mesazhit të të rinjtë për të kontribuar në dobi të komunitetit.



# GUSHT



Me datë 11 - 15 gusht u organizua Open Fun Football School.

Qëllimi i këtij aktiviteti është shoqërimi i fëmijëve në mes veti. Aktiviteti është mbajtur në stadiumin e qytetit "Shahin Haxhiislamit" në Pejë, në bashkëpunim me klubet e qytetit të Pejës. Hapjen solemne e bëri Kryetari i Komunës së Pejës z.Gazmend Muhaxheri. Aktiviteti ka qenë multietnik. Në këtë projekt kanë qenë të përfshirë 192 fëmijë të ndarë në 12 grupe me moshë prej 7-12 vjeç djem dhe vajza 10-14vjeç.



# GUSHT



Me datë 13 gusht për nder të Ditës së Rinisë është organizuar Paraglajding nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport -Sektori i Rinisë në bashkëpunim me Aeroklubin Peja.

Një grup i të rinjëve përjetuan emocionet duke u lëshuar nga Maja e Zezë.

# GUSHT



Me datë 29 gusht 2014 u bë pritja solemne për Kampionen e Botës në xhudo Majlinda Kelmendin. Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri dhe e organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Peja ka organizuar pritje solemne për Kampionen e Botës, Majlinda Kelmendin, e cila fitoi medaljen e artë si dhe për trajnerin botëror Driton Kuka. Kryetari Muhaxheri e uroi Majlindën për fitoren e medaljes së artë dhe i uroi fitore të njëpasnjëshme dhe përkrahje nga Komuna e Pejës. Majlinda Kelmendi i falënderoi të gjithë për pritjen madhështore që i bën në qytetin e saj të lindjes dhe në veçanti e falënderoi Kryetarin Muhaxheri.



# SHTATOR



Nga 1 shtator deri më 31 nëntor 2014 u mbajt kursi i Gjuhës Angleze për të rinjtë Pejanë, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi kursin e Gjuhës Angleze falas për të rinj nën organizimin e Sektorit të Rinisë në bashkëpunim me Këshillin e Veprimit Rinor Lokal. Kursi zgjatë 3 muaj dhe është falas dhe në dobi të mësimnxënies nga ana e rinisë. Pjesëmarrës kanë qenë nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Pejës. Pjesëmarrja ka qenë gjithëpërfshirëse.



# SHTATOR



Me datë 18 shtator 2014 në Qendrën Rinore Peja u mbajt turniri në lojën mes dy zjarreve me shkollat fillore të qytetit të Pejës. Ky aktivitet u mbajt në vazhden e aktiviteteve për nder të Muajit të Rinisë. Shkollat fituese janë:

1. Sh.M.U "Asdreni" dhe fitues të kupës
2. Sh.M.U "Vaso Pashë Shkodrani - vendi i dytë
3. Sh.M.U "Lidhja e Prizrenit- vendi i tretë

Diona Krasniqi ishte lojtarja me e dalluar në këtë aktivitet sportiv dhe u shpërblye me mirënjohje.



# SHTATOR



Turniri i Basketit me shkollat e mesme të Komunës së Pejës.

Me datë 17 shtator 2014 në Qendrën Rinore Peja u mbajt aktivitet sportiv në basketboll për nder të Muajit të Rinisë. E veçantë e këtij aktiviteti ishte dhe shpërblimi i shkollave fituese:

- 1.Vendi i parë- Sh.M "Bedri Pejani"
- 2.Vendi i dytë - Sh.M "Odhise Paskali"
- 3.Vendi i tretë - Sh.M " Shaban Spahija"

Lojtari i dalluar i turnirit u shpërblye me mirënjohje -Leondrit Luci

# SHTATOR



Më datë 24 dhe 25 shtator 2014 Shfaqet pjesa Teatrale "Radio Iliria"  
Në teatrin e qytetit "Istref Begolli" të mbështetur edhe nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, sektori i Kulturës duke filluar nga ora 19:00 u dha Shfaqja teatrale "Radio Iliria" si dhe repriza u dha të nesërmen për publikun. Në Rolin kryesor ishte aktori më famë botërore Arben Bajraktaraj si dhe në rolet tjera, Mërkur Bozgo, Erjeta Cufaj, nën regji të Erand Sojli.



# SHTATOR



Me datë 16 shtator 2014 në Qendrën Rinore Peja u mbajt turniri në lojën basketboll me shkollat e mesme të ulët të qytetit të Pejës.

Ky aktivitet u mbajt në vazhden e aktiviteteve për nder të Muajit të Rinisë ku tashmë tradicionalisht data shtator ne Komunën e Pejës festohet me shumë aktivitete rinore.

Shkollat fituese janë:

1. Sh.M.U "Lidhja e Prizrenit" dhe fitues të kupës

2. Sh.M.U "Xhemajl Kada" - vendi i dytë

3. Sh.M.U "Vaso Pash Shkodrani" - vendi i tretë

Dion Idrizi ishte lojtarja me e dalluar në këtë aktivitet sportiv dhe Sh.M.U "Vaso Pash Shkodrani"

# SHTATOR



Via Ferrata josh vizitoret

Me datën 20 shtator 2014, një grup i të rinjëve vizituan shtegun Via Ferrata që është organizuar nga DKRS - Sektori i Rinisë në bashkëpunim me OJQ Merimangat e Pejës.

Ky aktivitet ishte vazhdimësi i aktiviteteve të organizuar për nder të Muajit të Rinisë, gjithashtu ishte edhe përmbyllja e Muajit të Rinisë.

Ishte një aktivitet shumë atraktiv, ku të rinjtë kaluan çaste shumë të mira së bashku dhe gjithashtu u motivuan për sporte rekreative që ofrojnë OJQ të ndryshme që merren me sporte rekreative.



# TETOR



Me 11 tetor 2014 u organizua Dita e Anti Diskriminimit në Pejë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport-Sektori i Sportit në bashkëpunim me OJQ Sport Sans Frontierës me përkrahjen edhe nga Agjensioni Austriak për Zhvillim ka organizuar Ditën e Anti-diskriminimit në Pejë. Aktiviteti ishte i larmishëm në fushën sportive si në futboll dhe rekreacione të tjera sportive. Pjesëmarrës ishin 120 fëmijë dhe 30 vullnetarë nga 6 lokalitete në Kosovë.



# TETOR



Me 15 tetor 2014 moren pjesë të rinjët sportiv në Turne tradicional Mbarëkombëtar në Durrës. Qendra Kulturore e Fëmijëve Durrës me mbështetjen e Bashkësisë dhe Drejtoratit Arsimit Rajonal i Durrësit organizuan Turneun e Njëmbëdhjetë Mbarëkombëtar të Futbollit grup moshë U-15 "Durrësi 2014". Pjesëmarrës ishin qytetet Durrës, Pejë, Tetovë, Ulqin dhe Bujanoc (Lugina e Preshevës). Ky turne synon bashkëpunimin dhe vëllazërimin e fëmijëve në të gjithë hapësirën mbarë Shqiptare. Garat u zhvilluan në sistem pikësh ndërsa ekipi i Pejës u shpallë fitues i Turneut të I I-të Mbarëkombëtar të Futbollit grup moshë U-15 "Durrësi 2014".



# TETOR



Ekspozitë personale e Guri Çavdarbasha në Galerinë e Arteve në Pejë

Me datë 24 tetor në Galerinë e Arteve në Pejë u mbajt ekspozita personale e artistit Guri Çavdarbasha e mbështetur edhe nga Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, sektori i Kulturës.

Në këtë ekspozitë morën pjesë përfaqësuesit e Drejtoratit për Kulturë Rini dhe Sport dhe dashamirët e artit ku janë ekspozuar një mori veprash të artistit në fjalë. Pjesëmarrës ishin dashamir të artit ndërsa ekspozita ka qenë e hapur prej datës 24 deri më 29 Tetor 2014.


# TETOR



Me datë 14 Tetor 2014 Ndeshja Futbollistike e Kombëtares Shqiptare Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi përcjelljen e ndeshjes Serbi – Shqipëri për eliminatorët Euro 2016 e cila u luajt në ora 20:45 në ambient të hapur në qendër të qytetit. Aktiviteti u përcjellë nga një numër i madh dashamirësh të futbollit dhe kombëtares sonë të cilët në numër të madh e përkrahën kombëtaren me zemër. Po ashtu aktiviteti është përcjellë më DJ muzik. Për pos dashamirëve të futbollit ndeshja është përcjellë dhe nga mediat.



# TETOR



DREJTORATI PËR KULTURË RINI E SPORT  
Sektori i Kulturës



## F T E S Ë

*Ftoheni që të merrni pjesë në përurimin e librit  
“Baca i Myzeqesë dhe Dardani i Reçakut”  
të autorit Fran Ukcama.*

*Përurimi organizohet në Sallën e Kuvendit të  
Komunës në Pejë, më 10. 10. 2014 në ora 11.00.*



Me datë 10 tetor 2014 promovim libri “ Baca i Myzeqesë dhe Dardani i Reçakut”

Nën organizimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, sektori i Kulturës,

duke filluar nga ora 11:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës në Pejë, është bërë promovimi i librit “ Baca i Myzeqesë dhe Dardani i Reçakut” të autorit Fran Ukcama.

Në këtë promovim të librit morën fjalën Kryetari i Komunës Z. Gazmend Muhaxheri, redaktori i librit Sulejman Dërmaku, recensionisti Dr. Sc. Faik Shkodra

Është bërë hapja me një poezi kushtuar Bacë Myzaqesë, në këtë libër është trajtuar një temë historike që shpalos mundimet dhe vuajtjet e popullit Shqiptarë të Kosovës në një kohë zezonë, kohë që solli tragjedi e tmerre të papara.

Më këtë rast në mes të bibliotekës “Azem Shkreli” në Pejë dhe asaj të Fierit u nënshkrua memorandum i binjakëzimit.

# NENTOR



Me datë 20 Nëntor Konferenca mbi Ditën Ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve, e organizuar nga DKRS në bashkëpunim me Trentino con il Kosovo.

Në këtë konferencë te ftuar si panelist ishin Kryesuesi i Asamblesë Komunale të Pejës, Dr. Islam Husaj, Presidenti i ATB z.Maurizio Camin, Drejtori i DKRS z. Engelbert Zefaj, Shefja e Sektorit të Rinisë znj.Jeta Nushi, zyrtari i të drejtave të fëmijëve z.Vlaznim Pergjegjaj, përfaqesuesi i mësuesve pa kufi në Trento z.Michele Tocoli si dhe Kryetari i KVRL z. Taulant Devolli.

Në këtë konferencë u diskutuan temat mbi Konventën e të drejtave të fëmijëve, u dhanë disa rekomandime për implementimin e tyre, përfaqësuesi nga Italia dha disa këshilla dhe sugjerime për implementimin e tyre dhe ndihmën që do të japin për të fuqizuar dhe respektuar Konvente e të drejtave të fëmijëve.

E gjithë kjo Konferencë u përmbyll me prezantimin e punëtorisë që ishte realizuar me dt. 13 Nëntor 2014 nga Sektori i Rinisë në bashkëpunim me KVRL dhe nxënësit e shkollave fillore të Komunës së Pejës.

Pas konferencës në Qendrën Rinore Peja në ora 13:00 u hap ekspozita e punimeve nga fëmijët me aftësi të kufizuar nga Qendra Jetë të Pavarur.

Pjesëmarrës në këtë ekspozitë ishin edhe nxënësit nga shkollat fillore të Komunës së Pejës dhe KFORI Italian.



# NENTOR




Me datën 30 Nëntor Palaço Show për fëmijët e Vitomericës.

Në Shtëpinë e Kulturës u organizua Palaço Show për fëmijët e Vitomericës. Organizator i kësaj ngjarjeje ishte OJQ CTI-P e komunitetit boshnjak.

Animatorët që janë pjesë e grupit "Palaço pa kufi" çdo vit sjellin për Komunën e Pejës animator të ndryshëm nga vendet më të ndryshme të botës.

Kësaj radhe ishin nga Finlanda dhe përformuan para fëmijëve të fshatit të Vitomericës. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin rreth 260 fëmijë.

# NENTOR




## Ekspozitë me Fotografi

Me datën 20 Nëntor 2014 në Galerinë e Arteve në Pejë është mbajtur ekspozita me fotografi në nderim të Aktivistës Rossana Fontanari e cila ka ndërruar jetë në një fatkeqësi komunikacioni dhe e cila ka dhënë shumë kontribut me projekte për qytetin e Pejës.

Rossana Fontanari, operatore në Trentino con i Balcani nga viti 2009 ka kontribuar në projekte të ndryshme në mes të Komunës së Pejës dhe Provincës Autonome Trentos, kontribut të veçantë në integrimin e të rinjëve nga këto dy territore në projekte Europiane për të rinjtë. Kjo ekspozitë është organizuar nga Trentino Con il Kosovo në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.



# NENTOR



Me datë 28 nëntor 2014 u organizua ekspozitë për nder të Ditës së Flamurit Shqipëtar.

Në Galerinë e Arteve në Pejë u mbajt ekspozita "Nëntori 2014" për nder të 28 Nëntorit Ditës së Flamurit të Shqipërisë. Në këtë ekspozitë morën pjesë shumë dashamirë të artit. Ekspozita u organizua nga Shoqata e Artistëve të Pejës në bashkëpunim më Drejtorin për Kulturë, Rini dhe sport sektori i Kulturës.

# NENTOR



Me datën 18 Nëntor dhurimi i librave në Bibliotekën “Azem Shkreli”  
Në Bibliotekën “Azem Shkreli” janë dhuruar libra, 33 tituj me 70 ekzemplar.  
Ky donacion është organizuar nga Drejtoresha e Bibliotekës Azem Shkreli. Drejtoresha e Bibliotekës “Azem Shkreli” dha mirënjohje dhe e falënderoi Universitetin AAB për donacionin e dhënë, në këtë mënyrë begatoi fondin e kësaj Biblioteke me botime të reja dhe përmbajtje cilësore në shërbim të kultivimit të dijeve ndër lexuesit e saj. Ky është hap i parë dhe do të jetë hap i bashkimit tonë të ndërsjellë.



# NENTOR





Me datë 27 nëntor 2014 u mbajt orë Letrare për nder të Ditës së Flamurit.

Për nder të Ditës së Flamurit sot në ambientet e Bibliotekës “Azem Shkreli” u mbajt orë Letrare Festive. Kjo ditë e bekuar dhe e shënuar për të gjithë ne ka qenë dhe mbetet simbol i bashkimit, unitetit, lidhjes, krenarisë, qëndresës dhe vendosmërisë së popullit shqiptarë.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, mbështet tashmë tradicionalisht këtë aktivitet të tillë poetik. Në këtë ngjarje kontribuan dhe nxënësit e shkollës fillore “Lidhja e Prizrenit” dhe “Asdrenit” etj. Karakteristika e aktivitetit është forcimi e ndërjegjes kulturore, duke krijuar një ndjenjë të qytetarisë, promovimin e vlerave të identitetit kulturor përmes nxitjes, zgjimit të kënaqësisë, dhe ndjenjën estetike të kënaqësisë ndaj vlerave kulturore.

# NENTOR



Me 21 nëntor 2014 Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me shkollën jo formale të baletit për fëmijë organizoi shfaqje artistike në Teatrin e qytetit "Istref Begolli".

Aktiviteti kishte për qëllim shënimin e 25 vjetorit të Ratifikimit të Konventës për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve. Shfaqja është përgatitur nga Shkolla jo formale e Baletit nën koreografin e maestros Tasim Dajqi i cili në mesin e 32 trupave të Baletit në Tiranë në festival e zuri vendin e parë.



# NENTOR



Me datë 21 nëntor 2014 palaço Show në kuadër të Ditës Botërore të Fëmijëve.

Në Teatrin "Istref Begolli" u mbajt shfaqja Palaço Show e organizuar nga

DKRS-sektori i Rinisë, në bashkëpunim me Organizatën Franceze Sport Sans Fointers.

Kjo shfaqje u realizua në kuadër të Ditës Botërore të Fëmijëve, 25 vjetori i Konventës mbi të drejtat e

fëmijëve. Palaçot erdhën nga Irlanda për të përformuar enkas për fëmijët e Pejës. Pjesëmarrës në këtë shfaqje

ishin nxënësit e shkollave fillore, ciklit të ulët dhe fëmijët e çerdheve si dhe fëmijët të tjerë të cilët u

entuziazmuan nga përformanca të Palaçove.

# NENTOR





Me datën 14 Nëntor zhvillimi i teknologjisë së informacionit për rrjetin kombëtar të bibliotekave. Në ambientet e Bibliotekës "Azem Shkreli" u mbajt takim lidhur me bashkëpunimin për të përvetësuar programin "KOHA" për automatizimin e proceseve bibliotekare në Bibliotekën Komunale të Pejës.

Është diskutuar për zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe për rrjetin kombëtar të bibliotekave për programin e automatizuar "KOHA" që është softuerë i lirë, i hapur, funksional, dhe pa pagesë. Ky program është në përdorim në mbarë botën, zhvillimi i tij është i drejtuar nga një komunitet në rritje të përdoruesve që bashkëpunojnë për të arritur qëllimet e tyre të teknologjisë dhe të ofrimit të informacionit bibliotekar.



# NENTOR



Me 16 nëntor 2014 u organizua World Caffé Methodology.

DKRS-Sektori i Rinisë në bashkëpunim me KVRL organizuan punëtori me nxënësit e Sh.M.U të Komunës së Pejës që u mbajtë në Qendrën Rinore "At Lorenc Mazreku".

Në këtë punëtori morën pjesë 30 nxënës përfaqësues të shkollave nga vinin duke përfshirë shkollat e qytetit dhe viseve rurale. Në këtë punëtori u përdor një metodologji e punës e quajtur World Caffé Methodology. Ishin caktuar 6 tema të ndryshme që kishin të bëjnë me problematiken e fëmijëve që janë të përfshira në Konventën e të drejtave të fëmijëve. Qëllimi i gjithë kësaj punëtorie ishte socializmi i fëmijëve dhe zhvillimi i mendimit kritik, rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve, familjeve dhe komuniteteve në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe fuqizimi i fëmijëve për të marrë pjesë në zhvillim dhe mbrojtjen e tyre.



# DHJETOR



Me 26 dhjetor 2014 u mbajt ekspozita e piktorit Nagip Berisha në Galerinë e Arteve në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport. Në emër të Drejtoratit fjalën përshëndetëse e mori zyrtari për Kulturë, Faik Zekaj si dhe Drejtori i Galerisë Zymer Mulliqi, Pjesëmarrës ishin shumë dashamirë të Artit në mesin e pjesëmarrësve ishte edhe Drejtori i Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport i Komunës së Gjilanit, si dhe artist të ndryshëm nga Peja dhe Kosova.



# DHJETOR



Me 05 - 08 dhjetor 2014 u organizua Grafit në Mur

Projekti tre ditor "Grafiti në Mur" organizuar nga DKRS-Sektori i Rinisë në bashkëpunim me OSBE-në. Në këtë projekt morën pjesë 30 të rinjë nga komunitete të ndryshme të Komunës së Pejës. Qëllimi i këtij projekti ishte bashkëveprimi i të rinjëve mes komuniteteve të ndryshme dhe involvimi i tyre në aktivitete rinore. Ndërsa mesazhi i grafitit ishte që qyteti i Pejës ofron mundësi për një bashkëjetesë sa më të mirë për të gjithë komunitetet. Po ashtu projekti ishte i përcjellur nga mediat.



# DHJETOR



Me datën 13 dhjetor 2014 koncert i muzikës Turke  
Në teatrin e qytetit "Istref Begolli" në Pejë u mbajt koncerti i muzikës artistike turke nga Shoqëria Kulturo-Artistike Dogru Yol. Në mesin e shumë të pranishmëve ishin Kryetari i Komunës z. Gazmend Muhaxheri me bashkëpunëtoret e tij si dhe ambasadorja turke znj. Songul Ozanm. Gjithashtu të pranishëm ishin edhe qytetarët e Komunës së Pejës që janë dashamirë të muzikës turke. Ky aktivitet u organizua nga Qendra Kulturore Turke Yunus Emre në Pejë.



# DHJETOR



Republika e Kosovës / Republika Kosove / Republic of Kosova  
Komuna e Pejes, Municipality of Peja, Opština Pec  
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport  
Direktorat za Umetnost, Omladinu i Sport



LIGA NDËR-INSTITUCIONALE E FUTBOLLIT TË VOGËL - PEJË  
**ORGANIZON**

**FAIR PLAY**

**FILLIMI I LIGES: 27 DHJETOR 2014**  
**PËRFUNDIMI: MARS 2015**  
**MARRIN PJESË: 12 EKIPE**  
**NDESHJET ZHVILLOHEN:**  
**ÇDO VIKEND NË PALESTREN E SPORTEVE "KARAGAÇ"**  
**REFERIMI PROFESIONAL**



Me datë 27 dhjetor 2014 nën organizimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është organizuar Liga Ndërinstitucionale e futbollit në Palestrën "Karagaçi". Pjesëmarrës ishin ekipe që përbëjnë institucionet në komunën e Pejës ku gjithsej janë 12 ekipe.

Çdo ekip pjesëmarrës ndeshet nga një herë në mes vete me sistem pikësh për çdo ndeshje.

# DHJETOR



Me datë 28 dhjetor 2014 Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport ndanë mirënjohje.

Në shenjë mirënjohjeje për kontributin e dhënë për Kulturën Pejane Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ndau mirënjohje për personalitete dhe OJQ. Fjalën përshëndetëse dhe falënderimi për këto personalitete e mbajti Drejtori i DKRS-së Phd.c Engelbert Zefaj i cili dhe ndau mirënjohjet për: Memli Kelmendin, Rudina Zhara, Tasim Dajqi, si dhe OJQ-et , Festivalin "Monoakt", "AniBar", Ansamblin "Rugova", Korin e shkollës së Muzikës "Halit Kasapolli", Të gjithë këta kontribut dhënës për Kulturën Pejane. Pas përfundimit të fjalimeve pati një koktej rasti dhe falënderimi.



# DHJETOR



Me datë 18 dhjetor 2014 u mbajt dëgjimi publik më OJQ dhe qytetar për Draft rregulloren e Qendrës Rinore Peja. Pasi që rregullorja për Kompleksin Rinorë është paraqitur dhe para asamblistëve dhe në parim ka marr mbështetje për procedura te mëtutjeshme. Ne këtë takim u diskutua rregullorja në terësi dhe si e tillë nuk kishte as një vërejtje. Te ftuar ishin OJQ'të dhe ato organizata qe ushtrojnë veprimtarinë e tyre ne këtë kompleks, pjesëtar të KVRL-së si dhe grupe jo formale. Kjo rregullore do të hyj në fuqi ne ditën kur do të miratohet në Kuvendin Komunal.



# DHJETOR



**TEATRI PROFESIONIST „ISTREF BEGOLLI„ PEJË**  
KOMEDI PËR FEMIJË  
**„ERDHA TË JU UROJ VITIN E RI,,**  
TEKSTI & REGJIA RUDINA ZHARA GRUDA  
INTERPRETOJNE :

**ARTI LEKA** **BLINA KASTRATI**  
**ARBRESHA ELEZAJ** **DONIKA AVDULLAHU**  
**ELIOS SHALA** **DORINA AVDULLAHU**  
**LORENA ZABUNI** **ARBA SHEREMETI**  
**LIRA ZAJMI** **ANILA GJIKOLLI**  
**JANINA BUÇAJ** **BLERINA KALIQANI**  
**OLSA ZATRIQI** **ELMA KALIQANI**  
**FLORINA REXHAJ** **OLSA IMAMI**  
**ERENISA ÇEKU** **ELSA REÇKOVIÇ** **ADEA LAJQI**  
**ZANA BERISHA** **DION SHOSHI**  
**DONART NIMANAJ** **GENTIANA HASANI**  
**LEANT HADERGJONAJ** **ROVENA GORANI**  
**ENSAR HADERGJONAJ** **EMA SADIKU**  
**DRITI BEGOLLI** **VITA SADIKU**

SKENOGRAFIA GRESA ZAJMI INSPICIENET LIRIDON NIKOJ - MUZIKA ROMINA ZHARA HDRICINI ALI THAQI

Me 28 dhjetor 2014 u mbajt shfaqja e zhanrit komedi për fëmijë “Erdha të ju uroj vitin e ri” në teatrin “Istref Begolli” në Pejë. Me regji dhe tekst të Rudina Zhara Gruda dhe në rolet të tjera kanë luajtur fëmijë të shkollave fillore të cilët interpretuan para publikut të pranishëm.



# DHJETOR



Me datë 29 dhjetor 2014 , në Teatrin e "Istref Begolli" u dha shfaqja teatrale e zhanrit komedi "Martesa" me regji të Ani Bibes. Në rolet tjera luajnë: Fitore Broqi , Fidan Mamusha, Herodita Ramshaj, Luan Daci, Agon Bala, Ani Biba. Kostumografe: Gresa Zajmi. Violinë: Rreze Gjuka, Soprano: Flutura Beqiraj, Ndriçimi: Ali Thaqi Shfaqja u realizua nga aktorët e rinj të Pejës, ndërsa publiku u nda i kënaqur dhe salla ishte e mbushur përplot.

Gusht.

Me datë 04.08.2014, Shqiptarët nga diaspora vizituan Shtëpinë e Kulturës në Vitomericë ku diskutuan për punët e Shtëpisë së Kulturës, aktivitetet të cilat realizohen dhe mundësi bashkëpunimi me shoqata të ndryshme në vende Evropiane ku gjinden Shqiptarët.

Me datë 14.08.2014 u organizua Hiking (Ecje një ditpr në Bjeshkë) u organizua nga Shoqata e Bjeshkatarëve "Gjeravica" për nder të Ditës së Rinisë ku morën pjesë një grupë të të rinjëve nga Peja.

Shtator:

Me datë 19-22.09.2014 u organizua Kolonia e Artistëve "Bjeshkët e Bardha 2014". Kolonia u realizua te Burimi i Drinit dhe morën pjesë 16 artistë nga treva të ndryshme shqiptare.

Tetor

Me date 03.10.2014 në teatrin "Istref Begolli" u mbajt shfaqja për fëmijë nga regjisorja Rudina Zhara Gruda.

Nëntor

Me date 01.11.2014 në teatrin "Istref Begolli" u mbajt koncerti i organizuar nga Komuniteti Egjiptian

Me date 08.11.2014 ne teatrin "Istref Begolli" u mbajt promovimi i librit të Qazim Taraku Berisha.

Me date 14.11.2014 ne teatrin "Istref Begolli" u mbajt program artistik nga Ansambli Rugova.

Me date 15.11.2014 ne teatrin "Istref Begolli" u mbajt program artistik të interpretuar nga mysafiret nga Italia të quajtur "Ne Parajse artistet mund te fluturojnë".

Dhjetor

Me date 01.12.2014 ne teatrin "Istref Begolli" u mbajt shfaqja për të rinjë për nder të Ditës Botërore Kundër Hiv-Aids të organizuar nga OJQ Nisma për paqe dhe unitet.

Me datë 01.12.2014 në Galerinë e Arteve në Pejë u mbajt ekspozite e Shoqatës së Gruas "Kundër dhunës"

Me date 04.12.2014 ne teatrin "Istref Begolli" u mbajt program për personat me aftësi të kufizuar.

Me datë 26.12.2014 në Galerinë e Arteve në Pejë u mbajte ekspozitë personale e piktorit akademik Nagip Berisha.

Me datë 30.12.2014 në Bibliotekën "Azem Shkreli" u mbajte takimi letrar me fëmijë dhe manifestimi i festave të fundvitit.





**Republika e Kosovës / Republika Kosove / Republic of Kosova**  
**Komuna e Pejes, Municipality of Peja, Opsina Pec**  
**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**  
**Direktorat za Umetnost, Omladinu i Sport**